


AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOOERISE

"TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK .

Ortaku i Vetëm: TUDOR-MOISE DOGAR, atësia Dogar Moise, amësia Fabian Rozalia, shtetas Shqiptar, lindur në Romana Rumani dhe banues në Romana, me adresë Jud.Ms Sat Sangeorgiu De Mures Str.Sudului Nr. 6a, lindur më 11/02/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes I ID nr. ZS245096 dhe nr. personal ZS245096 ,me vullnet të lirë e të plotë mbeshtetur ne:

Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin Nr. 9723 date 03. 05. 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", harton akt themelimi e statutin e shoqerise me pernjegjesi te kufizuar me emertimin **"TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK**

NENI 1

KRIJIMI

Shoqëria është person juridik i se drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. (SHPK)

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitetin juridik nga data e regjistimit te saj në QKB (Qendra Kombetare e Biznesit), në përputhje me kushtet e procedurat e parashikuara ne ligjin nr.9723 dt.3.5.2007. Shoqëria qe ne momenti qe ka fluar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 3

SELIA

Shoqëria e ka selinë në Kavaje , Kryemëdhenj, ne pasurine Apartament me Nr. pasurie 124/1+1-2, ndodhur në zonën kadastrale Nr. 2291 .

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakut të Vetëm.

Keto organizohen dhe administrohen me vete dhe ushtrojnë veprimtari me pale te treta, ne emer te shoqerise.

Nese dega ose zyra e perfaqsimit do te krijoje një faqe interneti, ato do te publikojne numrin unik te identifikimit te shoqerise ne kete faqe interneti.

NENI 4


OBJEKTI KRYESOR I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka objekt te veprimtarise se saj, aktivitetin: Ndertimi i sistemeve te energjise se gjelber (hidroenergjia, energjia diellore, energjia e eres) perqatitja e sistemeve, importi i paisjeve.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pa caktuar.



Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe me vendim te ortakut te vetem per motive te bazuara ne ligj.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut si vijon:

Ortaku TUDOR-MOISE DOGAR eshte zoterues i nje kuote e barabarte me vleren 100.000 leke te kapitalit fillestar qe perben 100% te kapitalit te shoqerise

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe ees me kontribute ne sherbime.

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne Vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 7

ZMADHIMI DNE ZVOGELIMI 1 KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimive te pjesave te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga organi kompetent te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 (dyzet e pese) dite perpara dates se mbledhjes Se Ortakut te Vetem te thirrur per te marre vendimin rrith ketij projekti.

NENI 8

TRANSFERIMI 1 KAPITALIT

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jani lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve.

'Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Neni 9

Me vendimin e ortakut te vetem shoqeria mund te shtoje ortake te rinj ku perqindja e kuotave te tyre do te jete ne ekuivalence me kontributin e derdhur I cili do te jete sipas vendimit te ortakut te vetem, duke u njoftuar kjo per regjistrim ne QKB.

Kuotat mund te pjesetohen per shkak te kalimit te tyre

NENI 10

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton dhe vendos per ceshtjet:

-Percaktimin e politikave tregetare te shoqerise,

-ndryshimin e statutit,

- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,

-Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

- mbikqyrjen e politikave tregetare nga admininistratoret, perfshire per gatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise.

-perfaqsimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Vendos per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,

Ortaku i vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit finanziar, miraton reportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratoret.

Ai mund te perfaqesohet edhe nga nje tjeter person.

NENI 11

Te gjitha vendimet e marrë nga ortaku I vetem regjistrohen ne nje register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Vendimet e pa regjistruar ne regjistrin e vendimeve janë absolutisht te pavlefshme.

NENI 12

ADMINISTRIMI

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise, per nje periudhe prej 5 vitesh, me te drejte riperterije, I cili mund te zgjidhet dhe jashte ortakeve te shoqprise.

Administrator i shoqerise eshte emeruar Z. TUDOR MOISE-DOGAR per nje periudhe kohe 5 vjecare qe nga momeli i emerimit, me te drejte riemerimi.

Tagrat e peifaqsimit te administratorit dhe cdo ndryshim I tij njoftohen per regjistrim prane QKB.

NENI 13

KOMPETENCAT

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave, që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve, që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin, që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statusi, që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit nuk i lejohet të marre hua te shoqëria, të jape pëlqimin në emer të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzënës apo te garantojë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Ne rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

NENI 14

PERGJEGJESITE

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligieve, për shkelje të statusit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e mareveshjeve te pamiratuara nga ortaku i vetem qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere merreveshjen, per te perballuar ato ne menyre individuale

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryrjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka te drejte te ngreje padi penale kunder administratorit.

Ortaku ka te drejte te ndjeke ne rruge ligjore shlyerjen e pote te demit, qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

NENI 15

Administratori ka te drejte e detyrohet :

-Te kryeje te gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare te percaktuar nga Asambleja e pergjithshme (oftaku I vetem.) -Te perfaqsoje shoqerine tregetare.

-Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.

-Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ia paraqit keto akte ortakut te vetem (ortakeve) per shqyrtim.

-Kryen regjistrimet dhe I dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, prane QKR, sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.

-Ti propozoje ortakut te vetem numrin e punonjesve te shoqerise , pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

-Shqyrton oferta te ndryshme dhe pergatit kerkesa te cilat ia paraqet Ortakut te vetem Ortakeve per miratim.

-Ndjek probleme te shoqerise ne marredhenie me persona fizike e juridike ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

-Ti propozoje ortakut te vetem per miratim strukturen e aparatit te shoqerise dhe krijimin e organeve tjera te nevojshme per realizimin e objektivave t+hoqerise.

NENI 16 VITI FINANCIAR.

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 22 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Per kete viti fillimi do te jete data e hapjes (regjistrimit) te shoqerise.


Perjashtimisht Viti i pare finanziar ka filluar diten e themelimit si person juridik.

NENI 17 BILANCI 1 SHOOERISE DIIE DIVIDENTET

Brenda 6 (gjashte) muajsh nga mbyllja e vitit finanziar mbledhja e ortakut te vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore te aktivitetit administratori ndjek nxjerrjen e bilancit kontabel te shoqerise nga eksperti kontabel I autorizuar, I cili kontrollon gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregetare te shoqerise.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar sic edhe parashikohet nga ligji.



Shoqeria mund tu shperndaje fitime ortakeve, (ortakut te vetem), vetem nese pas pagimit te dividentit :

- Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj,
- nese Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

Administratori (administratoret) leshojne nje certificate te aftesise paguese qe konfirmon se shpemdarja e dividenteve permbush kerkesat e paragrafit te mesiperrn.

NENI 18

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gie te tille i ngarkuar nga ana e Ortakut te Vetem.

NENI 19

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Ortaku i vetem, i cili jo vetem qe dokumeton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, l«ijimin e fondit te veqante etj.

NENI 20

Te ardhurat neto (dividenti) qe mbeten pas vegimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, Ortakut te vetem te shoqerise.

NENI 21

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte kHjuar sic mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare" Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregetare.

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne te cilen parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne qdo dokument te nxjerre prej tij emrin e li idatm•it dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim "


Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit te emertuar nga Asanblea e shoqerise (ose Ortaku i Vetem), bazuar ne nenin 191 pika 2, te ligjit 9901 dt. 14.04.2008.

Nese Ortaku i Vetem nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar rmund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

NENI 22

Likuiduesi merr persiper te drejat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij. Nese shoqeria ka shume se nje likuidues, pervecse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryejne veprime te nje kategorie te



posacme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit.

NENI 23

Afati i emerimit te likuiduesit , publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e QKB.

NENI 24

Likuiduesi eshte i detyruar qe te jete i vemannshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1 .Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.

3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergaatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergaatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet miratohen nga asambleja e per gjithshme. (Ortaku i Vetem)

NENI 25

Perfundimi i Likuidimit

Pas shpemdarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon c'regjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligji nr.9723, date 3.5.2007 'Per Qendren Kombetare te Regjistrimit'

NENI 26

BASHKIMI DHE NDARJA

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimnine e saj disa shoqerive te reja. Ortaku i vetem i shoqerise, qe ben kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfiton pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompesim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10% (per qind) te vleres nominale te pjesave te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise, qe zhduket, dhe kalimin e pote, te trashegimnise ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesish per ortaket e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes .



Neni 27
MOSMARREVESHEJET


Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksim përkatës.
Ligji zbatues është ligji shqiptar.

Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale., me vlera te njejtë juridike ne referim te ligjit 9901 dt 14.04.2008,, Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare,, dhe me vullnet te lire e te plote te ortakut themelues ne prani te perkthyesit Tomi Papadhopulli.

ORTAKU I VETEM


I SHOQERISE "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK

TUDOR-MOISE DOGAR



PERKTHYESI

TOMI PAPADHOPULLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER IRMA BROCI



DATE 20/11/2023
NR REP 3290

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 20 nentor 2023 dymije e njezet e tre, para meje Noter IRMA BROCI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.11, Kruga "Don Bosko", Kulla nr.1, u paraqit personalisht:

TUDOR-MOISE DOGAR, atësia Dogar Moise, amësia Fabian Rozalia, shtetas Shqiptar, lindur në Romana Rumani dhe banues në Romana, me adresë Jud.Ms Sat Sangeorgiu De Mures Str.Sudului Nr. 6A, lindur më 11/02/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilin u garantova me pasaporten ID nr. ZS245096 dhe nr. personal ZS245096, .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Notere, Irma Broci "Autorizim per perfaqesim", bashkëlidhur, per shoqerine


"TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK hartuar me vullnetin e tij te lire dhe e ka nenshkruar rregullisht ate ne prezencen time.

Akti ju perkthye themeluesit te shoqerise ne gjuhen e tij rumune nga perkthyesi i tij i besuar i zgjedhur prej tij, shtetasi z Tomi Papadhopulli, atësia Petraq, amësia Hedi, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Don Bosko; Nd. 45; H. 8; Ap. 35; Njësia Administrative Nr. 11; Tiranë; 1026; Tiranë, lindur më 14/06/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilin u garantova me Leternjoftim ID nr. 033839197 dhe nr. personal F70614087F, njojur dhe pranuar nenshkruesit, i cili deklarozi ne pranine time noterit se e ka perkthyer identik aktin e mesiperm ne gjuhen e tij dhe e ka nenshkruar ne akt me ate cilesi ne prani te noterit ne kete zyre noterie, per te cilen shtetasi nenskruas deklarozi se e kuptoi dhe ishte dakort per sa me siper.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
IRMA BROCI





AUTORIZIM PER PERFAQESIM

Sot në Tiranë unë i nënshkruari :

TUDOR-MOISE DOGAR, atësia Dogar Moise , amësia Fabian Rozalia, shtetas Rumun, lindur në Romana Rumani dhe banues në Romana, me adresë Jud.Ms Sat Sangeorgiu De Mures Str.Sudului Nr. 6a, lindur më 11/02/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. ZS245096 dhe nr. personal ZS245096 , me cilësinë e administratorit te shoqërisë " "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK Shpk. deklaroj se :

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr.9723/2007, ligji nr.9901/2008 dhe të Akt themelimit e Statutit të shoqërisë, autorizoj zotin Tomi Papadhopulli, (lindur ne Tirane me 14.06.1957, mbajtes i leternjoftimit me numer personal F70614087F), për të përfaqësuar shoqërinë, shoqeri ne krijim e sipër, në kryerjen e aplikmit, nga Portali e-albania, si dhe me prezence, për regjistrimin ne Organet shteterore, si Qendra Kombetare e Biznesi (regjistrimin ne regjistrin tregtar dhe regjistrin e Pronarit Perfitues), Tatime, Banka te nivelit te dyte, Bashki, si dhe ne çdo institucion ku eshte i nevojshem regjistrimi per fillim e veprimtarise se shoqerise "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK

Ai ka të të drejtë të dorëzojë prane QKB Pasqyrat Financiare te Vtit 2023 e ne vazhdim.

AUTORIZUES "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK

Përfaqësuar nga administratori i saj

TUDOR-MOISE DOGAR
Dogar Moise
TD

Tomi Papadhopulli
TD

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER IRMA BROCI**



**DATE 20/11/2023
NR REP 3290**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 20 nentor 2023 dymije e njezet e tre, para meje Noter IRMA BROCI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.11, Rruga "Don Bosko", Kulla nr.1, u paraqit personalisht:

TUDOR-MOISE DOGAR, atësia Dogar Moise, amësia Fabian Rozalia, shtetas Shqiptar, lindur në Romana Rumani dhe banues në Romana, me adresë Jud.Ms Sat Sangeorgiu De Mures Str.Sudului Nr. 6A, lindur më 11/02/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilët u garantova me pasaporten ID nr. ZS245096 dhe nr. personal ZS245096, .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Notere, Irma Broci "Autorizim per perfaqesim ", bashkëlidhur, per shoqerine

"TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK hartuar me vullnetin e tij te lire dhe e ka nenshkruar rregullisht ate ne prezencen time.

Akti ju perkthye themeluesit te shoqerise ne gjuhen e tij rumune nga perkthyesi i tij i besuar i zgjedhur prej tij, shtetasi z Tomi Papadhopulli, atësia Petraq, amësia Hedi, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Don Bosko; Nd. 45; H. 8; Ap. 35; Njësia Administrative Nr. 11; Tiranë; 1026; Tiranë, lindur më 14/06/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilët u garantova me Leternjoftim ID nr. 033839197 dhe nr. personal F70614087F, njohur dhe pranuar nenskruesit, i cili deklaroji ne pranine time noterit se e ka perkthyer identik aktin e mesiperm ne gjuhen e tij dhe e ka nenshkruar ne akt me ate cilesi ne prani te noterit ne kete zyre noterie, per te cilen shtetasi nenskrues deklaroji se e kuptoi dhe ishte dakort per sa me siper.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përpunhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTESE
IRMA BROCI**





V2023054320243379405

AUTORIZIM PER PERFAQESIM

Sot në Tiranë unë i nënshkruari :

TUDOR-MOISE DOGAR, atësia Dogar Moise , amësia Fabian Rozalia, shtetas Rumun, lindur në Romana Rumani dhe banues në Romana, me adresë Jud.Ms Sat Sangeorgiu De Mures Str.Sudului Nr. 6a, lindur më 11/02/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. ZS245096 dhe nr. personal ZS245096 , me cilësinë e administratorit te shoqërisë " "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK shpk. deklaroj se :

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr.9723/2007, ligji nr.9901/2008 dhe të Akt themelimit e Statutit të shoqërisë, autorizoj zotin Tomi Papadhopulli, (lindur ne Tirane me 14.06.1957, mbajtes i leternjoftimit me numer personal F70614087F), për të përfaqësuar shoqerinë, shoqeri ne krijim e siper, në kryerjen e aplikmit, nga Portali e-albania, si dhe me prezence, për regjistrimin ne Organet shteterore, si Qendra Kombetare e Biznesi (regjistrimin ne regjistrin tregtar dhe regjistrin e Pronarit Perfitues), Tatime, Banka te nivitet te dyte, Bashki, si dhe ne çdo institucion ku eshte i nevojshem regjistrimi per fillim e veprimtarise se shoqerise "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK

Ai ka të të drejtë të dorëzojë prane QKB Pasqyrat Financiare te Viti 2023 e ne vazhdim.

AUTORIZUES "TUDOR'S 68 ENERGY" SHPK

Përfaqësuar nga administratori i saj

TUDOR-MOISE DOGAR